



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2657 prot.

Fushë-Arrëz, më 2.09.2025

VENDIM

Nr. 29, datë 27.08.2025

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ 2025-2028”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, VKM nr.334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”; Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; neni 36 i Ligjit nr.121, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e Llogaritjes së Fondeve për Financimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”, pika 11; shkresën nr. 2171, datë 15.04.2019 Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit; Projektit dhe Relacionit të paraqitur nga Administrata e Bashkisë Fushë-Arrëz me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e datës 27.08.2025, pas shqyrtimit,

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Social Vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028, sipas Planit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Sociale; Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe personat përgjegjës sipas zyrave përkatëse.
3. Ky vendim u zbardh me datë **2.09.2025** dhe hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz me:

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

